



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1024/Prot.

Tiranë, më 11/05/2020

**VENDIM**

Nr. 39, Datë 11.05.2020

**“PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR (KIZ), NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të nenit 36, pika 7 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencorë në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese ...” i ndryshuar, si dhe Urdhrin nr.108, datë 08.05.2020 “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet...”, të nenit 6, Pika 1 të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores ...”, dhe sipas rendit të ditës Senati Akademik pasi mori në shqyrtim aplikimet e kryera në sekretarinë e tij dhe pas procesit të votimit të fshehtë,

**VENDOSI:**

1. Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë ( 3 (tri) përfaqësues të Fakultetit të Mjekësisë, 2 (dy) përfaqësues të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 1 (një) përfaqësues të Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe 1(një) përfaqësues i studentëve të UMT-së) sipas anëtarëve të zgjedhur.
2. Të shpallë fitues Kandidatët për Komisionin Institucional Zgjedhor (KIZ) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si më poshtë:

Nga Personeli Akademik:

- Irena Seferi (Fakulteti i Mjekësisë)
- Silvana Bala (Fakulteti i Mjekësisë)
- Albana Banushi (Fakulteti i Mjekësisë)
- Migena Gega (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike)
- Niko Hyka (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike)
- Andis Qendro (Fakulteti i Mjekësisë Dentare)

Nga Studentët:

- Dea Cenomeri (Fakulteti i Mjekësisë)

3. Të caktojë si Sekretar të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, z. Edvin Selmani.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETARI**  
**ARBEN GJATA**

